REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË ____________
NR. 1330 ________ Rep.
NR. 613 ________ Kol. 11

Taksa e Pullës u Likuidua

**KONTRATË SHTESË KONCES**
**PËR**
**DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, PRONËSINË, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALEVE NË LUMIN ZALLI I OKSHTUNIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË BAZUAR NË VKM NR. 448, DATË 16.06.2010**

Në Tiranë, më datë 28, muaji Tetor, viti 2012 (dymijeedymbedhjete), para meje noter ____________, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë ____________, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,** në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar nga z. Nasip Naço, i datëlindjes ____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftimi nr. ____.

**DHE**

**Shoqëria koncesionare** “DITEKO” sh.p.k., e cila figuron e rregjistruar si person juridik ne QKR me NIPT ____ date ____, përfaqësuar nga Z. Shkelqim Golli, i datëlindjes ____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr.

**Palët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë**:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së koncesionit të formës BOT, të nënshkruar nga palët Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkimit te shoqërive “2 T”shpk & “Perxhola” shpk & “ “Albaldi” shpk & “ME – AJ” shpk & “Mixtecnik” shpk & “UDSA” shpk, për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Zalli i Okshtunit, datë 03 Qershor 2009, me Nr. 1924 Rep., nr. 230Kol., miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 11.06.2009, botuar në fletoren zyrtare nr. 114, datë 24.07.2009.

# Hyrje

**Duke pasur parasysh që:**

- Në VKM nr. 27, datë 19.01.2007 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", kreu V, pika 2 (a), i ndryshuar, është parashikuar se "*...Autoriteti Kontraktor, në bazë të një vlerësimi, mund të japë një afat deri në 12 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet deri në 5 MW, deri 18 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet nga 5 deri 20 MW dhe deri në 24 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion mbi 20 MW, për marrje lejeje dhe përgatitje projekti" dhe "....Të gjitha shoqëritë koncesionare, të cilat, deri në hyrjen të fuqi të këtij vendimi, nuk e kanë parashikuar afatin e nevojshëm të marrjes së këtyre lejeve në kontratat koncesionare përkatëse, kanë të drejtë ta shtyjnë afatin.....*

  *.... Shtyrja e afatit të pasqyrohet, për çdo rast, në kontratat shtesë të palëve në koncesion. Ministri përgjegjës i miraton këto kontrata, të cilat hyjnë në fuqi me firmosjen e saj nga palët.*" .
- në Grafikun e Punimeve (Aneksi 2) nuk është parashikuar afati i nevojshëm për marrjen e lejeve.(pika 5 (a), e Udhëzimit).

  Referuar Pikës 6, të Udhëzimit Nr.873, datë 13.12.2010 "*Për përcaktimin e kritereve për shtyrjen e afateve të përgatitjes së projekteve të zbatimit dhe marrjes së lejeve në kontratat koncesionare të miratuara*", koncesionari ka të drejtë të përfitojë ***24 muaj shtesë afati*** , mbi atë të përcaktuar në kontratë.

Në Kontratën e koncesionit të formës BOT për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Zalli i Okshtunit, nenshkruar datë 02 Qershor 2009, me Nr. 3722 Rep., nr. 488 Kol./4, datë 03 Qershor 2009, me Nr. 1924 Rep., nr. 230Kol., miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 11.06.2009, të bëhen këto ndryshime:

## Neni 1

Në nenin 10, *"Programi i punimeve*":

Pika 2, zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

"Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralet brenda 108 (njeqindetete) muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te kontrates dhe ne perputhje me grafikun e punimeve te paraqitur ne Aneksin 2, bashkelidhur.

Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 24 (njezetekatër) muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit "

**Neni 2**

Kjo kontrate shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata shtesë e koncesionit u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi u lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe une noteria e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

**PALËT**

| | |
|---|---|
| **AUTORITETI KONTRAKTUES** | **SHOQERIA KONCESIONARE** |
| **Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës** | **"DITEKO" sh.p.k.** |
| **Përfaqësuar nga :** | **Përfaqësuar nga :** |
| **z. Nasip NAÇO** | **z. Shkelqim Golli** |


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

mbiemri/surname
Golli
emri/given name
Shkëlqim
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Borove
datëlindja/date of birth
03-01-1972
data e lëshimit/date of issue
03-03-2009
autoriteti lëshues/authority
MB

nr. leternjoftim/card no.
024473378
gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
02-03-2019
nr. personal/personal no.
H20103135C

firma/signature